

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në lexim

Fokusi në PISA 2009

- A janë nxënësit të përgatitur për t'u ballafaquar me sfidat e së ardhmes?
- A janë ata të aftë të analizojnë, arsyetojnë dhe komunikojnë idetë e tyre në mënyrë sa më efektive?
- A janë ata të pajisur siç duhet për të vazhduar të nxënët përgjatë gjithë jetës?

Konteksti i përgjithshëm

- PISA 2009 e përcakton leximin si kuptimin, përdorimin, reflektimin dhe angazhimin me tekste të shkruara, për të arritur një qëllim, për të zhvilluar njohuritë dhe potencialin e lexuesit dhe për të marrë pjesë në shoqëri.

Kultura e leximit

- Koncepti i kulturës së të lexuarit përdoret në një aspekt më të gjerë sesa thjesht nocioni i aftësisë për të lexuar.
- Kultura e leximit matet si zhvillim dhe jo si diçka që një individ e zotëron ose jo.
- Përftimi i kësaj kulture është një proces që zgjat tërë jetën dhe që nuk ndodh vetëm në shkollë gjatë procesit formal të mësimin, por nëpërmjet ndërveprimeve me familjen, bashkëmoshatarët, anëtarë të komunitetit e më gjerë.

PISA 2009 i kategorizon tekstet sipas:

- mënyrës përmes të cilës ato komunikojnë;
- mjedisit që krijojnë;
- potencialit të lexuesit për të ndikuar në përmbajtjen e tekstit;
- formatit;
- tipit.

Llojet e teksteve

- Në Shqipëri janë përdorur tekste të printuara, ku u prezantuan variante:
- broshurash,
- revistash dhe
- librash.

Formati i teksteve, Si është prezantuar teksti?

- Tekste të vazhdueshme: (prozë, pjesë të ndryshme tregimesh, novelash, prezantime të ndryshme, argumentim, etj)
- Tekste jo të vazhdueshme: (grafikë, formularë, lista).
- Tekste të përziera: (të dy llojet e mësipërme të teksteve).
- Tekste të shumëfishta: përcaktuar si një koleksion tekstesh që gjenerohen në mënyrë të pavarur dhe që vetëm në këtë formë marrin kuptim.

Tipi i teksteve, Cila është struktura retorike e tekstit?

- Përshkrues: si, të një vendi apo ditari, katalogu, harte gjeografike dhe specifikimin e një tipari, funksioni apo procesi në një manual teknik.
- Narrativ: si, novela, histori të shkurtra, biografi, raportime të ngjarjeve në një gazetë.
- Parashtrues: si, një diagram, një grafik mbi tendencën e popullatës, ese.
- Argumentues: si, një reklamë, komente mbi një libër apo film, një letër drejtuar një redaktori.
- Udhëzues: si, një recetë, një seri diagramesh, që tregojnë procedurat e dhënies së ndihmës së parë.

Aspektet e vlerësimit (në PISA 2009 u vlerësuan tri aspekte):

- marrja dhe gjetja e informacionit;
- integrimi dhe interpretimi;
- reflektimi dhe vlerësimi.

Arritjet e nxënësve PISA 2000-2009

- PISA 2000 dhe PISA 2009 janë fokusuar në lexim.
- Kjo na mundëson të shikojmë ndryshimet që kanë pësuar arritjet e nxënësve në lexim gjatë kësaj periudhe.
- Midis disa vendeve të tjera edhe Shqipëria ka përmirësuar dukshëm arritjet e saj, krahasuar me vitin 2000, ku ajo mori pjesë në vlerësim.

Shqipëria e treta me rritjen më të madhe

- Shqipëria vendi i tretë ndër gjithë vendet me rritjen më të madhe krahasuar me PISA 2000.
- Ka një rritje me 36 pikë për të gjithë nxënësit, një ndryshim ky i konsiderueshëm dhe statistikisht mbi mesataren e OECD.
- Ky ndryshim te djemtë shfaqet me një mesatare prej 35 pikësh dhe te vajzat me 39 pikë.

Kjo tregon që:

- arritjet e një vendi në lexim nuk janë të pamundura;
- në zhvillim nuk ndikojnë diferencat kulturore;
- zhvillimi ekonomik ka ndikim pozitiv.

Nxënësit tanë shfaqin arritje të mira në:

- lokalizimin e një pjese të informacionit në një tekst të thjeshtë;
- krahasimin e informacionit;
- kombinimin e pjesëve të ndryshme të informacionit brenda një teksti;
- identifikimin e ideve të thjeshta, që përmenden disa herë në tekst;
- interpretimin e një fraze, në tekst të shkurtër apo çështje të njohur;
- identifikimin e temës qendrore apo qëllimit të autorit, në një tekst që trajton një çështje të njohur;
- identifikimin e kuptimit të një fjalë apo fraze;

- krijimin e një lidhjeje të thjeshtë midis informacionit të dhënë në tekst dhe njohurive të zakonshme të jetës së përditshme;
- krahasimin apo lidhjen midis tekstit dhe njohurive të jashtme;
- të shpjegojë një tipar të tekstit nisur nga përvoja apo qëndrimet personale.

Vështirësi në:

- ballafaqimin me tekste të një natyre jofamiljare për ta;
- integrimin informacionit të marrë nga tekste të ndryshme;
- identifikimin e ideve të panjohura më parë;
- gjenerimin e kategorive abstrakte për zhvillimin e interpretimeve të ndryshme;
- vlerësimin në mënyrë kritike të një teksti kompleks mbi një çështje të panjohur;
- zbatimin e një kuptimi të sofistikuar përtej tekstit;
- vlerësimin në mënyrë kritike teksteve të ndryshme dhe ngritjen e hipotezave rreth tyre, duke zhvilluar njohuri të specializuara dhe duke përpunuar koncepte që mund të jenë të kundërshtim me pritshmërinë.

Faktorët që ndikojnë rezultatin

Të gjitha rezultatet e arritura në PISA 2009, për të gjitha vendet pjesëmarrëse, shikohen të ndikuara nga arsye të tilla si:

- konteksti social-ekonomik në arritjet arsimore;
- konteksti familjar;
- angazhimi i nxënësve;
- burimet, politikat dhe praktikatat që e bëjnë një shkollë të suksesshme.